



**KOLEGJI DARDANIA**

# **TREGUESIT KRYESORË TË PERFORMANCËS**

*Ky doracak ju shërben të interesuareve që të njoftohen me cilësinë e veprimtarisë dhe të shërbimeve që ofron Kolegji Dardania*

Prishtinë, 2023

## **Fjala e Rektorës**

Kolegji Dardania si institucion privat i arsimit të lartë gëzon performancë të shkëlqyer të bazuar në përparësitë që i disponon. Së pari, ky institucion ndodhet në qendër të qytetit i shoqëruar me institucione të arsimit të lartë dhe institucione kulturore si muzeume etj. Ky lloj dislokimi fizik në qendër të qytetit studentëve i mundëson të shfrytëzojnë trafikun urban për ardhje dhe vajtje.

Përparësi shumë e rëndësishme e Kolegjit Dardania është se disponon me një infrastrukturë moderne të dizajnuar me standarde moderne për zhvillim cilësor si institucion i arsimit të lartë. Kjo infrastrukturë moderne ofron hapësirë të volitshme për studentët, konkretisht kur është fjala për raportin hapësirë-studentë. Infrastruktura shoqërohet edhe me hapësira përcjellëse si salla mësimi, biblioteka dhe me zyret funksionale për shërbime studentore.

Kolegji Dardania gëzon përparësi substanciale me zhvillimin e një game të gjërë të programeve studimore të karakterit multidiciplinar qoftë në nivelin bachelor apo edhe master. Programet studimore realizohen nga mësimdhënësit që disponojnë ekspertizë të shkëlqyer në fushën e njohurive teorike shkencore, hulumtimeve shkencore përkatëse si dhe me praktika të avancuara.

Kjo koherencë cilësore ka dhënë një kontribut shumë të vlefshëm në formësimin e studentëve të diplomuar si të suksesshëm në mjediset ku punojnë dhe veprojnë. Veprimtaria e tyre njëkohësisht ndikon në zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor të shoqërisë kosovare. Kolegji Dardania me qëllim të avancimit të programeve realizon një bashkëpunim me organizatat ekonomike të biznesit, organizatat qeveritare dhe jo qeveritare etj. Mbi këtë bazë të partneritetit është arritur të avancohen edhe më tej programet studimore. Si vlerë e shtuar e performancës së Kolegjit Dardania konsiston në ekzistimin e Zyrës për Orientim të Karrierës e cila ofron informacione studentëve për mundësi të punësimit në tregun e punës.

Kjo performancë e Kolegjit Dardania do të mbetet synim i përhershëm i tij.

Rektorja,

Prof. Dr. Gjyldane Mulla

## PËRMBAJTJA

Fjala e Rektores.....	1
Lista e shkurtesave.....	6
<b>HYRJE</b> .....	<b>7</b>
<b>1. Mësimdhënia dhe mësimnxënia</b> .....	<b>9</b>
<b>2. Puna kërkimore shkencore/artistike</b> .....	<b>11</b>
<b>3. Sigurimi i cilësisë dhe akreditimi</b> .....	<b>12</b>
<b>4. Niveli i studimeve dhe programet e kërkuara nga tregu i punës</b> .....	<b>12</b>
<b>5. Zhvillimi i burimeve njerëzore</b> .....	<b>13</b>
<b>6. Zhvillimi i sistemit të IT-së</b> .....	<b>15</b>
<b>7. Llogaridhënia fiskale dhe përmirësimi i informacionit financiar të të dhënave</b>	<b>15</b>
<b>8. Zhvillimi i infrastrukturës</b> .....	<b>15</b>
<b>9. Globalizimi/ndërkombëtarizimi</b> .....	<b>17</b>
<b>10. Shërbimi ndaj komunitetit-shoqërisë</b> .....	<b>18</b>
<b>11. Promovimi i Kolegjit Dardania</b> .....	<b>18</b>
<b>Përfundimi</b> .....	<b>18</b>

## **Lista e shkurtesave**

ZSC - Zyra për Sigurimin e Cilësisë

KQSCV - Komisioni Qendror për Sigurimin e Cilësisë dhe Vlerësimin

PSK - Planifikimi Strategjik i Kolegjit

TKP - Treguesit Kryesorë të Performancës

QPM - Qendra për Përsosmëri në Mësimdhënie

## **HYRJE**

Treguesit kryesorë të performancës, të quajtur edhe TKP, janë elementët e planit të institucionit që shprehin rezultatet sasiore që kërkohen të matën për të konstatuar suksesin e arritur të Kolegjit.

Treguesit kryesorë të performancës në arsimin e lartë janë vlera të matshme që përdoren nga institucionet arsimore për të matur dhe ndjekur përparimin në objektiva specifike. Këta tregues ndihmojnë institucionet arsimore të monitorojnë/vëzhgojnë dhe vlerësojnë efektivitetin e arritur, duke udhëhequr formulimin e politikave dhe përcaktimin e synimeve.

Treguesit kryesorë të performancës janë masa që ofrojnë informacion dhe të dhëna statistikore, të cilat mundësojnë krahasimin dhe vlerësimin e përparimit drejt një qëllimi të caktuar. Ata konsiderohen një mjet i rëndësishëm administrativ për të monitoruar progresin drejt arritjes së objektivave strategjike:

- Janë masat që ofrojnë informacion dhe të dhëna statistikore që lejojnë krahasimin dhe përcaktimin e përparimit drejt një qëllimi të caktuar.
- Janë një mjet i rëndësishëm administrativ për të monitoruar progresin drejt arritjes së qëllimeve strategjike.
- Janë tregues statistikore që ofrojnë një masë subjektive për performancën e institucioneve të arsimit të lartë si masa numerike të shkallës së arritjeve të qëllimeve.

Treguesit kryesorë të performancës janë një nga mjetet që ndihmojnë për t'iu përgjigjur pyetjes së rëndësishme: *Si mund të dimë se çfarë kemi arritur?* Përveç kësaj, krahasimi me institucionet e tjera të arsimit të lartë përmes këtyre treguesve na ndihmon të marrim përgjigje për pyetjet e mëposhtme:

- Ku qëndrojmë në krahasim me të tjerët?
- Cilat janë fushat që duhen përmirësuar?
- Cilët janë universitetet me rezultatet më të mira për krahasim me aktivitetet tona?
- Si mund të ndjekim shembullin e këtyre universiteteve?
- Si mund të arrijmë një nivel më të lartë përsosmërie si këto universitete?

Por, pse na duhen treguesit e performancës?

TKP shërbejnë për të matur:

- Sa mirë po funksionon një sektor brenda institucionit;
- Treguesit udhëzojnë vendimarrësit për vlerësimin;
- Cilësinë e vendimmarrjes;
- Vlefshmërinë e provave/të dhënave, kahjen e drejtimit strategjik;
- Cilësinë e politikave dhe menaxhimit të Kolegjit;
- Ata mund të japin të dhëna për performancën e përgjithshme;
- Ata mund të kontribuojnë në ngritjen e cilësisë së veprimtarisë së përgjithme të Kolegjit;

Çka udhëzojnë treguesit e performancës?

- ✓ Identifikojnë fushat që kanë nevojë për përmirësim dhe zhvillim.
- ✓ Tregojnë ku duhet ndërhyrë.
- ✓ Kontribuojnë në promovimin e përmirësimit të vazhdueshëm.
- ✓ Ndihmojnë në krijimin e një mjedisi organizativ të mësimi.
- ✓ Matin dhe përcaktojnë përparimin.
- ✓ Tregojnë ku duhen adresuar zhvillimet dhe përmirësimet me studentët.
- ✓ Ndikojnë në ndryshimin e kulturës së institucionit.

Cilat janë qëllimet e treguesve kryesorë të performancës?

- ✓ Ndihmojnë institucionin arsimor të përcaktojë dhe të matë përparimin drejt arritjes së qëllimeve të tij.
- ✓ Sigurojnë informacion të besueshëm mbi performancën dhe cilësinë e institucionit arsimor.
- ✓ Mundësojnë institucionit të krahasojë punën e tij me atë të institucioneve të tjera.
- ✓ Ndihmojnë në procesin e monitorimit të performancës dhe zhvillimit, duke kontribuar në përmirësimin e vazhdueshëm të institucioneve.

Cila ishte metodologjia e zhvillimit të treguesve kryesorë të performancës për Kolegjin Dardania?

Komisioni Qendror për Sigurimin e Cilësisë dhe Vlerësimin, gjatë hartimit të këtij dokumenti, është mbështetur në dokumentet e Kolegjit, përfshirë Statutin, Planin Strategjik, rregulloret dhe materialet e tjera mbështetëse, si dhe ka konsultuar modele të treguesve të performancës të universiteteve prestigjioze.

Në Planin Strategjik identifikimi dhe matja e Treguesve Kryesorë të Performancës (TKP) konsiderohen thelbësorë për arritjen e suksesshme të qëllimeve dhe objektivave të përcaktuara.

Zyra për Sigurimin e Cilësisë të Kolegjit Dardania ka ndërmarrë vlerësime të rregullta (semestrare e vjetore). Gjatë muajve të fundit, në takime të rregullta dhe në bashkëpunim të ngushtë me menaxhmentin e kolegjit, u identifikuan dhe u hartuan treguesit e performancës së Kolegjit. Paketa e treguesve të performancës do të përditësohet çdo vit, dhe bazuar në rezultatet e arritura, do të planifikohen aktivitete që synojnë përmirësimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të treguesve specifikë. Plani Strategjik i Kolegjit për periudhën 2023-2027 ka përcaktuar nëntë objektiva kryesore dhe dy specifike që do të udhëheqin Kolegjin Dardania në arritjen e vizionit të tij gjatë kësaj periudhe. Për të përmbushur këto objektiva, janë identifikuar një numër i Treguesve Kryesorë të Performancës, të cilët do të prezantohen në vijim.

## TREGUESIT KRYESORË TË PERFORMANCËS

### 1. Mësimdhënia dhe mësimnxënia

Procesi i mësimdhënies dhe mësimnxënies është kryesori për aktivitetin akademik të Kolegjit Dardania. Ky proces synon të zhvillojë njohuritë dhe aftësitë e studentëve në aspektin teorik dhe praktik të fushave të ndryshme, me qëllim të përgatitjes së tyre për tregun e punës dhe për kontributin e tyre në zhvillimin e komunitetit. Kolegji Dardania, synon të ofrojë programe akademike të një standardi të lartë të krahasueshëm me institucionet e arsimit të lartë në zonën Europiane të arsimit të lartë.

Në vijim do të prezantojmë treguesit e performancës që janë specifikë për mësimdhënie dhe mësimnxënie në Kolegjin Dardania.

**1.1. Raporti midis kandidatëve që kanë aplikuar dhe numrit të tyre që studentëve pranuar për çdo program studimi**

**1.1.1.** Ky tregues i performancës jep informacion për cilësinë e përzgjedhjes së studentëve si rezultatë i konkurrencës në programe studimore.

**1.1.2.** Ky tregues i performancës na ofron një informacion të numrit të aplikuesve në raport me numrin e përgjithshëm të studentëve të pranuar në tri vitet e fundit në Kolegjin Dardania.

**1.2. Përformanca e arritshmërisë të studentëve**

**1.2.1.** Ky tregues paraqet shkallen e arritshmërisë të suksesit të studentëve të bazuar në notën mesatare të tyre të dal nga ngarkesa e punës të studentit, e cila është në përputhje me specifikat e syllabuseve të programeve të studimit.

**1.2.2.** Ky tregues i performancës paraqet notën mesatare të studentëve për tre vitet e fundit të studimit.

**1.3. Braktisja e studimeve**

**1.3.1.** Ky tregues përcakton shkallën e përqindjes të braktisjes së studimeve nga ana e studentëve në Kolegjin Dardania (për arsye të ndryshme). Ky tregues paraqet raportin në mes studentëve që e kanë braktisë studimet në krahasim me numrin total të studentëve të regjistruar për tre vitet e fundit.

**1.4. Transferimi i studentëve nga një Kolegj në një tjetër.**

Sipas dispozitave të Statutit të Kolegjit Dardania:

**1.4.1.** Studentët kanë mundësinë për të ndryshuar programin e tyre studimor, duke përfunduar studimet në një program të caktuar dhe duke filluar studimin në një program (përmes barazvlerësimit të ngarkesës së studentit) tjetër në të njëjtin departament ose në një departament tjetër akademik të Kolegjit.

**1.4.2.** Këto ndryshime janë të lejuara midis programeve të studimit, me qëllim të sigurimit të një niveli studimor të njëjtë të arsimit të lartë, në përputhje me rregulloret e Statutit të Kolegjit.

**1.4.3.** Studentët që ndërrojnë programin e studimit mund të regjistrohen në programin e ri të studimeve, nëse kanë përfunduar me sukses së paku 50% të provimeve të programit të mëparshëm dhe janë pranuar në programin e ri të studimeve.

**1.4.4.** Sipas përcaktimit të pikës 3, studentit i lejohej të regjistrohet në programin e ri të studimeve bazuar në Treguesit Kryesorë të Performancës:

**1.4.4.1.** Në vitin e dytë të studimeve ose

**1.4.4.2.** Në vitin e studimeve që vijon pas përfundimit të programit të mëparshëm të studimeve.

**1.4.5.** Transferimi i programit të studimeve nuk mund të realizohet nëse studentit i kërkohet të regjistrohet sërish në vitin e parë të studimeve në programin e ri, sipas dispozitave të pikave 3 dhe 4.

**1.4.5.1.** Treguesi i transferimit është raporti midis numrit të studentëve që janë transferuar nga Kolegji "Emri i Kolegji \_\_\_\_\_" në raport me numrin e studentëve para transferimit. Raporti paraqet përqindjen e performancës qoftë pozitive apo negative.

**1.5.** Diplomimi i studentëve

**1.5.1.** Performanca matë vlerësimin e studentëve të cilët kanë diplomuar në afatin e duhur kohor.

**1.5.2.** Performanca kalkulohet për secilin njësi akademike ndarazi, duke marrë parasysh numrin total të semestrave për të plotësuar kërkesat për diplomim. Përmes grafikëve, prezantohen të dhënat për numrin e studentëve që kanë diplomuar sipas programeve të studimit për të gjitha departamentet akademike, si dhe raportin midis studentëve që kanë diplomuar në kohë dhe atyre që do të duhej të diplomonin.

**1.6.** Të diplomuarit tanë

**1.6.1.** Treguesi i performancës shpreh numrin e studentëve që kanë përfunduar studimet BA në Kolegji, dhe, brenda gjashtë muajve pas diplomimit:

- a) janë të punësuar,
- b) kanë vazhduar studimet master,
- c) nuk janë të punësuar, dhe
- d) nuk kanë vazhduar studimet.

**1.7.**Ngarkesa mësimore e një profesori matet në bazë të numrit të total të studentëve aktiv / përnumrin e mësimdhënësve dhe asistentëve.

**1.7.1.**Numri total i studentëve të një profesori me ngarkesë të plotë mësimore për profesorë në nivelin e Kolegjit, gjatë tre viteve të fundit.

**1.7.2.**Numri total i studentëve të një profesori me ngarkesë të plotë mësimore përprofesorë në nivelin e njësisë akademike, gjatë tre viteve të fundit.

## 1.8. Raporti teori-praktikë

**1.8.1.** Treguesi i performancës i shprehur në % tek syllabusët, paraqet ndërlidhjen mesteorisë dhe praktikës sipas njësive studimore të Kolegjit.

**1.8.2.** Treguesi i performancës i shprehur në % tek syllabusët, paraqet ndërlidhjen mesteorisë dhe praktikës në nivelin e Kolegjit.

## 1.9. Numri i programeve të reja në tre vitet e fundit

**1.9.1.** Tregues i performancës paraqet numrin e programeve të reja të ofruara brenda Kolegjit në tre vitet e fundit.

**1.9.2.** Tregues i performancës tregon numrin e drejtimeve të reja të ofruara në njësitë akademike në tre vitet e fundit.

## 2. Puna kërkimore shkencore/artistike

Në kuadër të *planifikimit strategjik* të Kolegjit Dardania të vitit 2023-2027, është planifikuar hartimi i *planit strategjik për hulumtimin shkencor*. Përveç objektivave strategjike të hulumtimit, plani përfshin aktivitete të hollësishme për të inkurajuar dhe mbështetur punën kërkimore shkencore të stafit akademik. Në këtë kuadër, është planifikuar riorganizimi i Qendrës për Hulumtime Shkencore të Kolegjit Dardania.

### 2.1. Publikimet shkencore

**2.1.1.** Treguesi i performancës shprehë numrin e publikimeve shkencore të botuara në revista shkencore ose libra dhe monografi të botuara nga stafi akademik sipas *njësive akademike* për vit.

**2.1.2.** Tregues i performancës shprehë numrin e publikimeve shkencore të botuara në revista shkencore ose libra dhe monografi të botuara nga stafi akademik në nivel *kolegji* për vit.

**2.1.3.** Tregues i performancës shprehë numrin e publikimeve shkencore të botuara në revista shkencore ose libra dhe monografi të botuara nga stafi akademik në nivel *kolegji* për tri vitet e fundit.

### 2.2. Konferencat shkencore

**2.2.1.** Treguesi i performancës shpreh përqindjen e pjesëmarrjes së stafit akademik në konferenca ndërkombëtare krahasuar me numrin total të stafit akademik në kolegji për vit (tre vitet e fundit).

**2.2.2.** Treguesi i performancës shpreh përqindjen e pjesëmarrjes së stafit akademik të njësive në konferenca ndërkombëtare për vit (tre vitet e fundit).

**2.2.3.** Gjithashtu, treguesi i performancës paraqet numrin e konferencave shkencore dhe simpoziumeve të organizuara me pjesëmarrje fizike ose online nga Kolegji Dardania brenda vitit akademik (tre vitet e fundit).

**2.2.4.** Treguesi i performancës paraqet numrin e konferencave shkencore dhe simpoziumeve të organizuara me pjesëmarrje fizike ose online nga njesitë akademike brenda vitit akademik (tre vitet e fundit).

### **2.3. Projektet Hulumtuese**

**2.3.1.** Treguesi i performancës shpreh numrin e projekteve hulumtuese të financuara nga buxheti vjetor i brendshëm i Kolegjit Dardania.

**2.3.2.** Treguesi i performancës shpreh numrin e projekteve hulumtuese të financuara nga agjencionet e jashtme përmes granteve të ndryshme.

### **2.4. Citimi i Publikimeve Shkencore**

**2.4.1.** Treguesi i performancës shprehë numrin e citimeve të punimeve në revistat e botuara për stafin akademik të Kolegjit Dardania [për tre vitet e fundit].

**2.4.2.** Treguesi i performancës shprehë numrin e citimeve të punimeve në revistat e botuara për stafin akademik sipas njësive akademike [për tre vitet e fundit].

### **2.5. Bashkëpunimi me Industrinë dhe Bizneset**

Përmes këtij treguesi të performancës, ne matim nivelin e bashkëpunimit me kompanitë prodhuese dhe bizneset që operojnë në vendin tonë.

**2.5.1.** Numri i takimeve me kompanitë prodhuese brenda vitit [për tre vitet e fundit].

**2.5.2.** Numri i ndryshimeve të ofruara në programe si pasojë e rekomandimit të kompanive.

## **3. Sigurimi i cilësisë dhe akreditimi**

Misioni kryesor i menaxhimit të cilësisë është përmirësimi i vazhdueshëm i performancës të njësive akademike veç e veç dhe të Kolegjit Dardania. Ky procesi mundësohet nga angazhimi i të gjitha palëve (stafit akademik, administrativ, alumnit, punëdhënësve dhe OJQ-vë etj.). Profesionalizimi i palëve të përfshira mundëson fuqizimin e sigurimit të cilësisë, duke mundësuar zhvillimin e aktiviteteve të rregullta të personelit akademik dhe administrativ.

**3.1.** Mekanizmat për sigurimin dhe zhvillimin e cilësisë në Kolegjin Dardania janë:

**3.1.1.** Komiteti Qendror për Sigurimin e Cilësisë;

**3.1.2.** Zyra për Sigurimin e Cilësisë;

**3.1.3.** Zyra për Orientim të Karrierës;

**3.1.4.** Qendra për Përsosmëri në Mësimdhënie

**3.1.5.** Koordinatorët për sigurim të cilësisë në kuadër të njësive akademike.

**3.2.** Për funksionimin efektiv të sistemit të cilësisë të Kolegjit Dardania është krijuar një pako me

instrumente përkatëse.

#### **4. Niveli i studimeve dhe programet e kërkuara nga tregu i punës**

Kolegji Dardania kurdoherë, kur planifikon programe të reja studimi ose drejtime në kuadër të programeve ekzistuese konsulton Entin i Statistikave të Kosovës, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, si dhe hulumtimi i nevojave të tregut të punës, analizon tendencat e tregut të punës në regjion dhe në disa vende të BE-së. Në mbështetje të akterëve dhe dokumenteve Kolegji Dardania zhvillon dhe aplikon për akreditim/riakreditim të programeve të veta studimore.

##### **4.1. Programe të nivelit BA,**

**4.1.1. Psikologji Aplikative dhe Studime Menaxheriale,**

**4.1.2. Përkujdesje dhe Mirëqenie Sociale,**

**4.1.3. Shkenca Politike dhe Administrim Publik.**

##### **4.2. Programe të nivelit MA**

**4.2.1. Programi Administrim Publik.**

#### **5. Zhvillimi i burimeve njerëzore**

Kolegji Dardania beson se cilësia e resurseve humane është thelbësore për cilësinë e përgatitjes akademike dhe profesionale të të diplomuarve. Procesit të rekrutimit të stafit akademik dhe administrativ i kushtohet rëndësi e madhe.

Personeli akademik i përfshirë në vazhdimësi në aktivitete arsimore dhe shkencore arrinë të përditesojnë kompetencën e tyre me zhvillimet e fundit në fushën e tyre të ekspertizës.

Personeli administrativ nëpërmes trajnimeve arrin të përfitoje njohuri të reja të cilat i mundësojnë që me kompetencën të realizojë detyrat dhe përgjegjësitë në vendin e punës.

##### **5.1. Personeli akademik**

Treguesi i performances të personeli akademik shprehet përmes numrit sipas:

- Kualifikimit;
- Thirrjes akademike;
- Gjinisë;
- Moshës.

##### **5.2. Personeli administrativ**

Treguesi i performances të personeli administrativ shprehet përmes numrit sipas:

- Kualifikimit;
- Gjinisë;
- Moshës;

- Përvojës;

### **5.3. Stafi teknik**

Treguesi i performances i stafit teknik shprehet përmes numrit sipas:

- Kualifikimit;
- Gjinisë;
- Moshës.

### **5.4. Raporti student/personel akademik**

**5.4.1.** Ky tregues performance tregon raportin student - personel akademik, në Kolegjit për tri vitet e fundit.

**5.4.2.** Ky tregues performance tregon raportin student - personel akademik, në nivel tënjesisë akademike për tri vitet e fundit.

### **5.5. Raporti student/staf administrativ**

**5.5.1.** Ky tregues performance tregon raportin student - staf administrativ, të Kolegjit për tri vitet e fundit.

**5.5.2.** Ky tregues performance tregon raportin student - staf administrativ, në nivel të njesisë akademike për tri vitet e fundit.

### **5.6. Raporti student/staf teknik**

**5.6.1.** Ky tregues performance tregon raportin student - staf teknik, të Kolegjit për tri vitet e fundit.

**5.6.2.** Ky tregues performance tregon raportin student - staf teknik, në nivel të njesisë akademike për tri vitet e fundit.

### **5.7. Promovimi**

Promovimi është treguesi i performances që shpreh avancimin e stafit të ndarë sipas kategorive:

- Stafi akademik;
- Staf administrativ;
- Staf teknik.

5.7.1. Promovimi i stafit akademik brenda vitit si njësi akademike dhe Kolegji;

5.7.2. Promovimi i stafit administrativ dhe mbështetës;

5.7.3. Promovimi i stafit teknik.

### **5.8. Trajnimi**

Ky tregues performance shpreh:

**5.8.1.** Numrin e **stafit akademik** të Kolegjit Dardania të cilët kanë ndjekur trajnime në tre vitet e fundit.

**5.8.2.** Numrin e **stafit administrativ** të Kolegjit Dardania të cilët kanë ndjekur trajnime në tre vitet e fundit.

**5.8.3.** Numrin e **stafit teknik** të Kolegjit Dardania të cilët kanë ndjekur trajnime në tre vitet e fundit.

## 5.9. Lëvizshmëria

Ky tregues performance shpreh nivelin e lëvizjes të **personelit** të Kolegjit Dardania [vit dhe për tri vitet e fundit] për shkak të:

- Pensionimit;
- Përfundimit të kontratës;
- Dorëheqjes.

**5.9.1.** Niveli i lëvizshmërisë të **stafit akademik** të Kolegjit dhe sipas njësisë akademike për tri vitet e fundit:

- Pensionimit;
- Përfundimit të kontratës;
- Dorëheqjes.

## 6. Zhvillimi i sistemit të IT-së

### 6.1. Paisjet teknologjike

Treguesi shpreh numrin e kompjuterëve për student, gjithashtu, numrin e softuerëve në shërbim të personelit akademik dhe studentëve.

**6.1.1.** Numri i kompjuterëve për staf akademik si Kolegj dhe si njësi akademike;

**6.1.2.** Numri i kompjuterëve për student si Kolegj dhe si njësi akademike;

**6.1.3.** Numri i softuerëve në shërbim të personelit akademik si Kolegj dhe si njësi akademike;

**6.1.4.** Numri i softuerëve në shërbim të studentëve si Kolegj dhe si njësi akademike.

## 7. Llogaridhënia fiskale dhe përmirësimi i informacionit financiar të të dhënave

Financat dhe transparenca e sistemit financiar dhe administrativ në Kolegjin Dardania shërbejnë si bazë për mbarëvajtjen e procesit të ofrimit të arsimit të lartë.

Kolegji Dardania, fushëveprimin dhe planifikimin e implementimit të politikave programore i realizon bazuar në Planin Strategjik të Arsimit të Lartë në Kosovë, Planin Strategjik të Kolegjit Dardania 2023-2027. Buxhetin e Kolegjit Dardania e karakterizon procesi i konsultimeve dhe sistemimi i kërkesave të administratës qendrore dhe të njësisë akademike. Kërkesat janë të harmonizuara me njësitë akademike duke konsideruar që aktivitetet të ndërliken me implementimin e përgjegjësive që janë përcaktuar me fushëveprimin e institucionit të Arsimit të Lartë në Kosovë.

## **7.1. Buxheti**

Ky tregues performance tregon shumën e buxhetit të Kolegjit Dardania për tri vitet e fundit si dhe tregon format e shpërndarjes së buxhetit.

**7.1.1.** Shumën e buxhetit të Kolegjit për tri vitet e fundit.

**7.1.2.** Mënyrën e shpërndarjes së buxhetit.

## **8. Zhvillimi i infrastrukturës**

Kolegji Dardania gjithmonë ka për qëllim të ofrojë mjedis të favorshëm për përmbushjen e objektivave të tij. Kjo përfshinë një sistem eficient të menaxhimit, disponimin e burimeve të duhura njerëzore dhe materiale në mënyrë që të përmirësojë vazhdimisht procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies.

Kolegji Dardania ofron kushte të mira mjedisore si për stafin ashtu edhe për studentët në mënyrë që të realizojnë në mënyrë cilësore procesin arsimor-edukativ. Sallat e ligjerimit janë të pajisura me orendi të përshtatëshme dhe teknologji moderne. Staf i akademik në mësimdhënie aplikon metodologji bashkëkohore ndërvepruese në aftësimin sa më cilësor e studentëve.

### **8.1. Kënaqësia e stafit**

**8.1.1.** Ky tregues performance ka të bëjë me matjen e nivelit të kënaqshmërisë së stafit sa i përket shërbimeve dhe çështjeve të ndryshme për të cilat janë hulumtuar përmes pyetësorëve.

### **8.2. Kënaqësia e studentëve**

**8.2.1.** Ky tregues performance e mat nivelin e kënaqshmërisë së studentëve për shërbimet që janë përfshirë në pyetësorë rreth mësimdhënies dhe mësimnxënies, poashtu, edhe për shërbimet e ofruara.

### **8.3. Aftësitë dhe kualifikimi i të diplomuarve**

**8.3.1.** Ky tregues performance na tregon se sa ju kanë ndihmuar studimet në Kolegjin tonë studentëve për tu adaptuar në tregun e punës sipas studentëve.

**8.3.2.** Ky tregues performance na tregon se sa ju kanë ndihmuar studimet në Kolegjin tonë studentëve për tu adaptuar në tregun e punës sipas punëdhënësve.

### **8.4. Biblioteka**

Përmes këtij treguesi ne e paraqesim numrin e titujve të librave në bibliotekë në raport

me numrin e studentëve si dhe shkallën e qasjes në bibliotekë.

**8.4.1.** Numri i titujve të librave në bibliotekë në raport me numrin e studentëve, si Kolegj.

**8.4.2.** Numri i titujve të librave në bibliotekë në raport me numrin e studentëve, sipas fakulteteve.

**8.4.3.** Shkallën e qasjes në bibliotekë [numri i studentëve të regjistruar krahasuar me numrin total të tyre], sipas fakulteteve.

**8.4.4.** Shkallën e qasjes në bibliotekë [numri i studentëve të regjistruar krahasuar me numrin total të tyre], si Kolegj.

**8.4.5.** Numri i linqeve elektronike të abonuara.

**8.4.5.1.** Bibloteka ABEK

**8.4.5.2.** Linqet e tjera.

## **8.5. Laboratorët**

**8.5.1.** Përmes këtij treguesi e masim numrin e laboratorëve dhe pajisjeve përcjellëse laboratorike në kuadër të Kolegjit.

**8.5.2.** Përmes këtij treguesi e masim numrin e laboratorëve dhe pajisjeve përcjellëse laboratorike në kuadër të fakulteteve.

## **8.6. Përshtatshmëria dhe cilësia e objekteve**

**8.6.1.** Ky tregues performance e mat përshtatshmërinë dhe cilësinë e objekteve në funksion të sigurimit të cilësisë.

## **9. Globalizimi/ndërkombëtarizimi**

**9.1.**Përmes këtij treguesi të performancës ne paraqesim numrin e marrëveshjeve të ndryshme të bashkëpunimit me institucione të ndryshme;

**9.2.** Përmes këtij treguesi të performancës ne paraqesim numrin e marrëveshjeve të ndryshme të bashkëpunimit me institucione të ndryshme si fakultete Treguesit Kryesorë të Performancës;

**9.3.** Numrin e organizatave/institucioneve ndërkombëtare në të cilët është i anëtarësuar Kolegji.

## **9.4. Bashkëpunimet e përgjithshme shkencore**

**9.4.1.** Ky tregues performance përfshin të dhënat brenda vitit rreth aktiviteteve kryesore në të cilat janë të angazhuar personeli akademik sipas klasifikimit më poshtë:

### **9.5. Bashkëpunimi ndërkombëtarë.**

Numri i aktiviteteve të realizuara ndërmjet Fakulteteve dhe institucioneve dhe organizatave ndërkombëtare, qoftë në mënyrë individuale apo si grupe.

**9.5.1. Joint cooperation.** Numri i aktiviteteve të bashkëpunimit ndërmjet një njësie akademike me një institucion tjetër jashtë Kolegjit.

**9.5.2 Postet drejtuese.** Numri i personelit akademik që shërbejnë nëpër borde të shoqërive kulturore dhe hulumtuese ndërkombëtare.

**9.5.3. Bordet editoriale.** Numri i personelit akademik që shërbejnë nëpër borde editoriale të revistave shkencore ndërkombëtare.

## **10. Shërbimi ndaj komunitetit/shoqërisë**

Si vlerë e shtuar e rolit të Kolegjit Dardania si një institucion i arsimit të lartë për nxerjen e të diplomuarëve të një nivelit të BA dhe MA përmes programeve unike në vendin tonë si dhe realizimit të hulumtimeve shkencore me cilësi ndërkombëtare, Kolegji Dardania i kushton rëndësi shumë të madhe bashkëpunimit me komunitetin gjithashtu. Kolegji Dardania luan rol kyç në komunitet përmes kontributit të madh për ofrimin e dijes dhe kontributin në aktivitete shoqërore dhe kulturore.

**10.1.**Të dhënat rreth numrit të aktiviteteve publike të stafit të Kolegjit Dardania si: ligjërata publike, publikime të artikujve të ndryshëm nëpër media, paraqitje të ndryshme nëpër media, sipas fakulteteve në vitë [për tre vitet e fundit].

**10.2.** Pjesëmarrja në aktivitete publike jashtë Kolegjit Dardania. Ky tregues performance e matë pjesëmarrjen e vizitorëve të jashtëm në universitet me rastin e aktiviteteve të ndryshme si dhe pjesëmarrjen e stafit të Kolegjit Dardania në aktivitete bamirësie apo vullnetare.

**10.3.**Të dhëna rreth numrit të vizitorëve të jashtëm në universitet me rastin e aktiviteteve të ndryshme.

**10.4.** Të dhëna rreth pjesëmarrjes së stafit të Kolegjit Dardania në aktivitete bamirësie apo vullnetare jashtë institucionit.

## **11. Promovimi i Kolegjit Dardania**

Ky tregues performance e shpreh promovimin e Kolegjit, të ndarë sipas kategorive:

**11.1.** Numri i vizitorëve të web faqes në vit, për tre vitet e fundit;

**11.2.** Numri i miqve të Kolegjit Dardania në rrjetet sociale;

**11.3.** Numri i videove promovuese të Kolegjit Dardania;

- 11.4.** Numri i dokumenteve të publikuara që përmbajnë statistika pozitive për Kolegjin Dardania;
- 11.5.** Numri i storieve të suksesit të publikuara për studentët aktualë;
- 11.6.** Numri i storieve të suksesit për studentët alumni;
- 11.7.** Numri i aktiviteteve të zhvilluara me student tre vitet e fundit;
- 11.8.** Numri i trajnimeve të ofruara për student dhe alumni;
- 11.9.** Numri i seancave të informimit në kampus;
- 11.10.** Numri i intervistave virtuale;
- 11.11.** Numri i rishikuar i CV-ve, letrave motivuese, dhe dokumenteve përcjellëse si portfoliot;
- 11.12.** Numri i aktiviteteve të organizuara dhe koordinuara në shërbim të studentëve;
- 11.13.** Numri i seancave këshilluese dhe orientuese në karrierë

## **PËRFUNDIM**

Për qëllime të përmirësimit të cilësisë së institucioneve të arsimit të lartë, institucionet duhet t'i shqyrtojnë dhe t'i masin treguesit kryesorë të performancës në baza periodike.

Kolegji Dardania si institucion i arsimit të lartë ka hartuar treguesit kryesorë të performancës përmes të cilëve identifikojmë pikat e forta, por, edhe hapësirat ku ka nevojë për përmirësim.

Matja dhe raportimi i treguesve të performancës për institucionin tonë do të shërbejë jo vetëm si mjet për ngritjen e cilësisë në ofrimin e arsimit të lartë por edhe si instrument matës kryesor për realizimin e planit strategjik të Kolegjit Dardania dhe evidentimin e nevojave për intervenim.

